

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Shef i pajimeve elektrike dhe avionik mekanik/teknik helikopteri	Reparti Ushtarak nr.3006, Farkë, Forca Ajrore	Farkë, Tiranë.	E Pacaktuar	Me dosje	-	26.10.2022	09.11.2022

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	Shef i pajimeve elektrike dhe avionik mekanik/teknik helikopteri
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.3006, Forca Ajrore
4. Vendi:	Farkë, Tiranë
5. Paga:	VKM Nr.234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Lidhja II, kreu II/1 me Klasën VI, (35000) dhe dëmshmëri dhe vështirësi shëndeti sipas shkallëve të përcaktuara nga Inspektoriati i Shëndetit Publik.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	26.10.2022
8. Data e mbylljes së aplikimit:	09.11.2022
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	
Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm	
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesën personale; • Formularin e aplikimit; • Fotokopje të kartës së identitetit; • Dëftesë e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin; • Diplomë e arsimit të lartë/liste notash të noterizuar me origjinalin; • Fotokopje të patentës nëse ka; • Dëshmi profesioni nëse ka; • Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja; • Raport mjekësor; 	

- Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 cope;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Librezë pune;
- Jetëshkrimin (CV).
- Formularin e vetëdeklarimit.

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: Kryerja në kohë dhe me cilësi e punimeve në teknikën fluturuese, gjendjen e përdorimit të rregullt të aparaturave matëse-kontrolluese, pajisjeve, instrumenteve dhe veglave të punës; zbatimin e masave të sigurimit teknik e ato kundër zjarrit.

Të njohë shumë mirë teknikën fluturuese në përdorim, rregullat e shfrytëzimit të saj dhe të gjitha llojet e punimeve që kryhen sipas afateve kalendarike dhe orare të përcaktuara në manualët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit.

Të përcaktojë rradhën e kryerjes së punimeve.

Të mbajë në gadishmëri të përhershme dhe në gjendje të mirë teknike pajisjet matëse-kontrolluese e veglat e punës, të kontrollojë afatet e përdorimit (kolaudimit dhe kalibrimit) të tyre.

Të eliminojë në kohë dhe me cilësi çdo defekt në teknikën fluturuese, të bëjë përgjithësimin e tyre dhe të propozojë masat parandaluese.

Të hartojë në kohë planin e bazës materiale për nevojat e teknikës fluturuese.

Të kontrollojë plotësimin në kohë dhe me cilësi të gjithë dokumentacionit teknik.

Të kryejë detyra shtesë në përshatje me nevojat e shërbimit kur kërkohet nga eprori.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për kryerjen në kohë dhe me cilësi të punimeve në teknikën fluturuese për mjetin që ka në ngarkim.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil (CII);
- Arsimi: I mesëm (Preferuar teknik elektrik)
- Kualifikimi: Të ketë eksperiencë pune si specialist/teknik elektrik.
Të ketë aftësi shumë të mira organizuese, komunikuese dhe prezantuese.
- Trajnimi: Të jetë i trajnuar në kurse të ndryshme në fushën që mbulon, njohuri në gjuhën angleze dhe njohuri bazë në përdorimin e programeve kompjuterik.
- Eksperienca në Punë: mbi 3 vjet.
- Gjuha e huaj: 2/1/2/1
- Kërkesa të tjera specifike: Përdorim të programeve bazë të kompjuterit dhe njohuri në fushën e veprimit.
- Niveli i certifikatës së sigurisë: e paaplikueshme

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I PERSONELIT

NËNKOLONEL VLADIMIR JAUPI